

PASQYRAT FINANCIARE

(Mbeshtetur ne Ligjin nr 9228 date 29.04.2004 " Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare " te ndryshuar , dhe ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit-SKK2 te Permiresuar)

Te dhena identifikuese

- Emri: **"Energy Partners AL" Shpk**
- NIPT: **K92129030I**
- Adresa: **"Rr. E Elbasanit Vila Nr.71"**
- Data e krijimit: **28/09/2009**
- Nr Rregj.Treg
- Fusha e veprimtarise: **Koncensionare Energji Elektrike**

Te dhena te tjera

- Pasqyrat financiare Individuale Te konsoliduara
- Monedha **LEK**
- Rrumbullakimi
- Periudha kontabel **2018**
Nga **01/01/2018** Deri **31/12/2018**
- Data e plotesimit te PF **31/03/2019**

Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci)

Nr	A K T I V E T	Shënime	2018	2017
	Aktivët Afatshkurtra			
	1 Aktivët monetare	4	203,103	170,149
	1 Banka		203,103	170,149
	2 Arka		0	0
	2 Investime		0	0
	1 Në tituj pronësie të njëjësive ekonomike brenda grupit			
	2 Aksionet e veta			
	3 Të tjera Financiare			
	3 Të drejta të arkëtueshme	5	52,480,808	48,334,847
	1 Nga aktiviteti i shfrytëzimit		50,161,466	48,334,847
	2 Nga njësitë ekonomike brenda grupit			
	3 Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
	4 Të tjera		2,319,341	
	5 Kapital i nënshkruar i papaguar			
	4 Inventarët	6	314,256	314,256
	1 Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme		314,256	314,256
	2 Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte			
	3 Produkte të gatshme			
	4 Mallra			
	5 Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)			
	6 AAGJM të mbajtura për shitje			
	7 Parapagime për inventar			
	5 Shpenzime të shtyra	7	11,925,583	11,925,583
	6 Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara			
I	TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA		64,923,750	60,744,836
	Aktivët Afatgjata			
	1 Aktive financiare	8	43,418,897	57,865,438
	1 Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit			
	2 Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit			
	3 Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
	4 Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
	5 Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata			
	6 Tituj të tjerë të huadhënies		43,418,897	57,865,438
	2 Aktivët materiale		2,072,935	2,306,865
	1 Toka dhe ndërtesa			
	2 Impiante dhe makineri	9	1,689,447	1,880,100
	3 Të tjera Instalime dhe pajisje	10	383,488	426,765
	4 Parapagime për aktive materiale dhe në proces			
	3 Aktivët biologjike			
	4 Aktive jo materiale:	11	660,377,921	737,207,836
	1 Koncesione, patenta, licenca, marka tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme		660,377,921	737,207,836
	2 Emri i Mirë			
	3 Parapagime për AAJM			
	5 Aktive tatimore të shtyra			
	6 Kapitali i nënshkruar i papaguar			
II	TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA		705,869,753	797,380,138
	AKTIVE TOTALE		770,793,503	858,124,974

Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci)

Nr	DETYRIMET DHE KAPITALI	Shënime	2018	2017
1	Detyrime afatshkurtra:		72,037,453	155,734,500
1	Titujt e huamarrjes	12	5,839	6,657
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë			
3	Arkëtime në avancë për porosi			
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	13	43,048,572	132,069,466
5	Dëftesa të pagueshme			
6	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit			
7	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
8	Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore	14	10,900,163	9,776,815
9	Të pagueshme për detyrimet tatimore	15	18,082,879	13,881,562
10	Të tjera të pagueshme			
2	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	16		12,510,676
3	Të ardhura të shtyra	17	49,493,964	61,889,422
4	Provizione	18	62,550	62,550
	Totali i Detyrimeve afatshkurtera		121,593,967	230,197,148
5	Detyrime afatgjata:		673,481,236	762,060,478
1	Titujt e huamarrjes			
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	19	475,021,961	538,931,780
3	Arkëtimet në avancë për porosi			
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	20	22,525,255	18,959,823
5	Dëftesa të pagueshme			
6	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit			
7	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
8	Të tjera të pagueshme	21	175,934,020	204,168,876
6	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara			
7	Të ardhura të shtyra			
8	Provizione:		0	0
1	Provizione për pensionet			
2	Provizione të tjera			
9	Detyrime tatimore të shtyra			
	Totali i Detyrimeve afatgjata		673,481,236	762,060,478
	DETYRIMET TOTALE		795,075,204	992,257,626
1	Kapitali dhe Rezervat			
2	Kapitali i Nënshkruar	22	1,000,000	1,000,000
3	Primi i lidhur me kapitalin			
4	Rezerva rivlerësimi			
5	Rezerva të tjera			
1	Rezerva ligjore			
2	Rezerva statutore			
3	Rezerva të tjera			
6	Fitimi i pashpërndarë		-135,132,652	-114,538,108
7	Fitim / Humbja e Vitit		109,850,951	-20,594,544
	Totali i Kapitalit		-24,281,701	-134,132,652
	TOTALI I DEYRIMEVE DHE KAPITALIT		770,793,502.65	858,124,974

Pasqyra e Performancës
(Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)

Formati 1 – Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës

Nr	Pershkrimi i Elementeve	2018	2017
1	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	218,518,752	97,391,402
2	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimin në proces		
3	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar		
4	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	9,893,460	10,310,273
5	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	-765,732	0
	1 Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	-44,672	
	2 Të tjera shpenzime	-721,061	
6	Shpenzime të personelit	-12,500,263	-12,791,263
	1 Paga dhe shpërblime	-10,768,975	-10,943,989
	2 Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)	-1,731,288	-1,847,274
7	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		
8	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	-77,063,844	-85,470,178
9	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	-14,302,934	-11,890,349
10	Të ardhura të tjera	0	0
	1 Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)		
	2 Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)		
	3 Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)		
11	Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra		
12	Shpenzime financiare	5,725,361	-15,505,229
	1 Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)	-23,461,475	-28,288,749
	2 Shpenzime të tjera financiare	29,186,836	12,783,520
13	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet		
14	Fitimi/Humbja para tatimit	129,504,800	-17,955,344
	1 Gjoha dhe penalitete	1,520,859	35,550,013
15	Fitimi Fiskal	131,025,659	17,594,669
16	Humbjet fiskale të mbartura		
17	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	-19,653,849	-2,639,200
	1 Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		
	2 Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë		
	3 Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve		
18	Fitimi/Humbja e vitit	109,850,951	-20,594,544
19	Fitimi/Humbja për:		
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë		
	Interesat jo-kontrolluese		

Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

Nr	Pershkrimi i Elementeve	2017	201
1	Fitimi/Humbja e vitit	109,850,951	-20,594,544
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		
	Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja		
	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		
	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje		
	Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet		
2	Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		
3	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		
4	Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për:		
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë		
	Interesat jo-kontrolluese		

Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare
(metoda indirekte)

	2018	2017
1 Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		
Fitim / Humbja e vitit	109,850,951	-20,594,544
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Shpenzimet financiare jomonetare		
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	77,063,844	85,470,178
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		
<i>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</i>		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie/(ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	-1,826,619	-12,808,376
Rënie/(ritje) në inventarë		
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	-97,331,071	6,379,063
Rritje/(rënie) në te ardhura/shpenzime te shtyra	-14,714,798	-11,548,447
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	1,123,348	2,077,056
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	74,165,655	48,974,929
2 Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Para neto të përdorura për blerjen e filialeve		
Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera		
Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera		
Dividentë të arkëtuar		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	0	0
3 Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		
Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral		
Hua të arkëtuara	14,446,541	14,259,632
Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë		
Riblerje e aksioneve të veta		
Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral		
Pagesa e huave	-88,579,242	-66,089,702
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare		
Interes i paguar		
Dividendë të paguar		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	-74,132,701	-51,830,070
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	32,954	-2,855,141
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 Janar	170,149	3,025,290
Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 Dhjetor	203,103	170,149

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto
Per vitin e mbylltur më 31 Dhjetor 2018

	Kapitali i nënshkuar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrolues	Totali
1	Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 Janar 2017	1,000,000	-	-	-	-	-	-135,132,652	0	0	-134,132,652
	Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:										0
	Fitimi / Humbja e vitit										0
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:										0
	Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:										0
	Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:										0
	Emetimi i kapitalit të nënshkuar										0
	Dividendë të paguar										0
	Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike										0
2	Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2017	1,000,000	-	-	-	-	-	-135,132,652	0	0	-134,132,652
3	Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 Janar 2018	1,000,000	-	-	-	-	-	-135,132,652	-	-	-134,132,652
	Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:										0
	Fitimi / Humbja e vitit							109,850,951			109,850,951
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:										0
	Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:										0
	Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:										0
	Emetimi i kapitalit të nënshkuar										0
	Dividendë të paguar										0
4	Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike										0
	Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2018	1,000,000	-	-	-	-	-	-25,281,701	0	0	-24,281,701

Sokol Meqemeja
Sokol Meqemeja
Administrator

Bilbil Zeneli
Bilbil Zeneli
Financiere



SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE TË SHOQËRISË “ENERGY PARTNERS AL” SHPK

Për ushtrimin financiar të mbyllur më 31 Dhjetor 2018

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria “Energy Partners AL” Shpk është shoqëri tregtare koncensionare e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Bisnesit më datë 28/09/2009 me NIPT K92129030I. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare” dhe nga statusi i saj.

Kapitali i shoqërisë është 1.000.000 Lek i zotëruar 70% nga ortakut “Frigo Food” Shpk dhe 30% nga ortakut “Nesh” Shpk.

Administratori i shoqërisë është Z.Sokol Meqemeja.

Selia e shoqërisë ndodhet tek Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga e Elbasanit, Vila Nr.71, Tiranë.

Aktiviteti kryesorë i shoqërisë është prodhimi i energjisë elektrike.

Ne 31 Dhjetor 2018 shoqëria ka 26 punonjës (2018)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar (SKIK) dhe Ligjit Nr. 9228 datë 29 Prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike.

(c) Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

(d) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

3. Politikat kontabël

(a) Transaksionet në monedha të huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 Dhjetor 2018 është i detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	<u>2018</u>
Euro/Lek	123.42
USD/Lek	107.82

(b) Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozitat me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

(c) Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbatur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë së skontuara me normën efektive të interesit.

(d) Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(e) Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve cdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

(f) Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

(g) Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur cdo humbje nga zhvlerësimi.

(h) Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

(i) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiare të matura me kosto të amorizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(j) Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

(k) Aktivitet afatgjate materiale

(i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afatgjate materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetëndrtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, cdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëlimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e cmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjate material, kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm të aktiveve afatgjate materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjate materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjate materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amorizimit mbi jetën e vlerësuar të cdo pjese të aktivitet afatgjate material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitet e marra me qera amorizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qerasë dhe jetës së dobishme të aktivitet.

Normat e amortizimit janë të paraqitura si më poshtë:

▪ Ndërtesa	5%
▪ Instalime&Makineri&Pajisje	20%
▪ Mjete transporti	20%
▪ Pajisje informatike	25%
▪ Mobilje,Orendi zyrash	20%

(iv) Cregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjate materiale cregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere

kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operative të vitit.

(l) Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e cfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi të blerë.

(m) Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytësimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata material dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

(n) Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

(o) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzime financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

(p) Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe cfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Normat e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15 % (2016: 15%)

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të paimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat priten të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

(q) Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritet Fiskale janë përgjegjës për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

(r) Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë konsiderohen si palë të lidhura.

(s) Provizionet

Një provision njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukes dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në cdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

(t) Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare po paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provision, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

SHËNIME MBI ZËRAT E LLOGARIVE NË PASQYRAT FINANCIARE

AKTIVET AFATSHKURTRA

4. Aktive monetare

Mjetet monetare në bankë më 31 Dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

Banka

Nr	Emri i Bankës	Monedha	Nr llogarisë	Vlera në valutë	Kursi fund vitit	Vlera në Lek
1	VENETO.ALL	ALL				-761
2	VENETO.ALL2	ALL				37,576
3	RZB.EUR	EUR				947
4	VENETO.EUR	EUR				36,568
5	RZB.USD	USD				6,379
6	SOCIETE.EUR					19,199
7	Vlera monetare, në lekë	ALL				103,195
			Totali			203,103

5. Të drejta të arkëtueshme

Të drejta të arkëtueshme më 31 Dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018
1	Faturat e pranuar nga OSHEE	411	4,385,982.00
2	Fatura e prodhimit per Dhejtorin nga OSHEE	411	6,801,296.00
3	Kliente te tjere	411	38,974,188
	Totali		50,161,466

Të detajuara inventari i klientëve është pasqyruar në tabelën bashkangjitur bilancit.

6. Inventari

Inventari më 31 Dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	Tuba 800 10 5000 L=12m	Metra	28	11,223	314,256
	Totali				314,256

7. Shpenzime të shtyra

Shpenzime të shtyra më 31 Dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018
1	Shpenzime të shtyra	486	11,925,583
	Totali		11,925,583

AKTIVET AFATGJATA

8. Aktive financiare

Tituj të tjerë të huadhënies më 31 Dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018
1	Të drejta të tjera afatgjatë nga palet e treta	467	43,418,897
	Totali		43,418,897

Të detajuara inventari i huadhënies ndaj palëve të treta është pasqyruar në tabelën bashkangjitur bilancit.

9. Aktivet materiale dhe instalime dhe pajisje

Makinerit e rënda dhe mjetet e transportit më 31 Dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Nr Ilog.	Gjendje 31.12.2018
1	Instalime teknike,makineri,pajisje, instrumente dhe vegla pune	213	1,689,447
2	Mjete transporti	215	383,488
	Totali		2,072,936

Të detajuara inventarët analitike të aktiveve janë të pasqyruara në tabelën bashkangjitur bilancit.

11. Aktivet Jo - Materiale

Aktivët Afatgjata Jo – Materiale – Koncensionit më 31 Dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Nr Ilog.	Gjendje 31.12.2018
1	Koncesion i Hece-ve - Rrype, Cerruje 1 dhe Cerruje 2	205	1,208,870,653
2	Amortizimi i koncesionit	2805	-548,492,732
	Totali		660,377,921

Aktivët Afatgjata Jo – Materiale - Koncensionit përfaqesojnë vlerën e ndërtesave Linjë, Nënstacion, Hec Rrype, Hec Cërruja 1, Hec Cërruja 2 për të cilat kanë përfunduar punimet dhe vlerën e makinerive dhe pajisjeve të vendosura në ndërtesa.

DETYRIMET AFATSHKURTRA

12. Titujt e huamarrjes

Titujt e huamarrjes më 31 Dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Nr. Ilog	Gjendje 31.12.2018
1	Titujt e huamarrjes – Raiffeisen Bank USD	4611	572
2	Titujt e huamarrjes - Intesa San Paolo-EUR	4611	5,618
	Totali		6,190

Titujt e huamarrjes përbëjnë balancat negative të llogarive bankare të shoqërisë.

13. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 Dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018
1	Furnitor për mallra,produkte dhe shërbime	401	43,048,572
	Totali		43,048,572

Të detajuara inventari i furnitoreve janë të pasqyruara në tabelën bashkangjitur bilancit.

14. Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore

Detyrimet ndaj punonjësit dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore më 31 Dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018
1	Paga dhe shperblime	421	10,142,546
2	Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	431	757,616
	Totali		10,900,163

15. Të pagueshme për detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore më 31 Dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018
1	Tatim burim	442	208,198
2	Tatim mbi fitimin	444	17,874,681
	Totali		18,082,879

16. Të pagueshme për shpenzime të konstatuara

Interesa pasive te llogaritura më 31 Dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018
1	Interesa pasive te llogaritura-BERZH	484	2,985,078
2	Interesa pasive te llogaritura-Veneto Banka	484	19,540,177
	Totali		22,525,255

17. Të ardhura të shtyra

Granti më 31 Dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018
1	Të ardhura të periudhave të ardhme nga Grantet	488	49,493,964
	Totali		49,493,964

Zëri i të ardhurave të periudhave të ardhme përbëhet nga granti i përfituar nga falja e borxhit sipas marreveshjes së huase të lidhur midis shoqërisë dhe BERZH-it.

18. Provizione afatshkurtra

Provizione afatshkurtra më 31 Dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018
1	Provizionet afatshkurtra (teprica debitore)	4631	62,550
	Totali		62,550

DETYRIMET AFATGJATA

19. Detyrime ndaj institucioneve të kredisë

Nr	Emërtimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018
1	Huamarrjet afat gjate –Veneto Banka	4681	302,667,772
2	Huamarrjet afat gjate –BERZH	4682	172,354,189
	Totali		475,021,961

21. Të tjera të pagueshme

Nr	Emërtimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018
1	Të drejta dhe detyrime ndaj ortakut “Frigo Food” Shpk	455	188,570,327
2	Të drejta dhe detyrime ndaj ortakut “NESH” Shpk	455	-12,636,306
	Totali		175,934,020

22. Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 1.000.000 Lek i zotëruar 70% nga ortakut Frigo Food Shpk dhe 30% nga ortakut Nesh Shpk.

Kapitali më 31 Dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018
1	Kapitali i paguar	101	1,000,000
2	Kapitali i nenshkruar i papaguar	102	0
	Totali		1,000,000

23. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018:

Nr	Emërtimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018
1	Të ardhura nga shitja e energjise elektrike	701	218,518,752
	Totali		218,518,752

25. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018:

Nr	Emërtimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018
1	Shpenzime paga për personel	641	-10,768,975
2	Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore	644	-1,731,288
	Totali - Shpenzime të personelit		(12,500,263)

26. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Shpenzime të tjera shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2018:

Nr	Emërtimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018
1	Qira per zyrat	613	-1,798,830
10	Fee koncesionare	668	- 6,448,033
11	Shpenzime te tjera	672	-6,056,071
	Totali		-14,302,934

27. Shpenzime financiare

Shpenzime të tjera janë gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018:

Nr	Emërtimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018
1	Shpenzime interesi te kredise Veneto Banka	667	-15,414,068
2	Shpenzime interesi te kredise BERZH	667	-8,047,407
	Totali		-23,461,475

28. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018:

Nr	Emertimi	Nr.llog.	Vlera
1	Rezultati ushtrimor		129,504,800
2	Shpenzime te panjohura		1,520,859
	<i>Kamatë vonesë (Interes)</i>		<i>314,179</i>
	<i>Gjoha Inspektori (0050)</i>		<i>80,715</i>
	<i>Gjobë Deklarim i Vonuar (0030)</i>		<i>40,000</i>
	<i>Gjobë Pagesë e Vonuar (0020)</i>		<i>1,085,965</i>
3	Totali		131,025,659
4	Minus humbjen fiskale te mbartur		0
5	Fitimi neto fiskal (8+9)		131,025,659
6	Tatim fitimi 15 %		19,653,849
7	Fitimi humbja (neto) fiskal (10-11)		111,371,810

Nr	Emërtimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2018
1	Tatim fitimi i parapaguar 1 Janar 2016		0
2	Parapagime gjatë vitit 2018		-1,247,037
3	Shpenzime tatim fitimi te vitit 2018		19,653,849
4	Tatim fitimi i parapaguar/(për t'u paguar)		18,406,812

Ngjarjet pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Tiranë më 31/03/2019

HARTOI

"ENERGY PARTNERS AL" Sh.p.k.
NIPT K 92129030 I
Tiranë - Albania

ADMINISTRATORI

Selal Koceri

Basil Zguri